



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

DSIK KONSTATON PAPËRSHTATSHMËRINË PËR VAZHDIMIN E DETYRËS PËR PROKURORIN FATMIR LUSHI

Gjatë monitorimit të seancës dëgjimore të zhvilluar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, me subjektin e vettingut, Z. Fatmir Lushi, Prokuror pranë Prokurorisë së Rrethit Elbasan, u morën në analizë vetëm dy nga tri kriteret e rivlerësimit të përcaktuara në ligjin 84/2016.

Lidhur me vlerësimin e pasurisë, në raportin e **ILDKPKI** konstatohet se: **deklarimi nuk është i saktë dhe në përputhje me ligjin**, ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë, nuk ka kryer fshehje të pasurisë, **ka kryer deklarim të rremë**, nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.

Pas hetimit të kryer Komisioni i ka kaluar barrën e provës subjektit lidhur me disa pasuri, për të cilat subjekti nuk kishte deklaruar burimin e krijimit në deklaratën periodike, ose gjendej në pamundësinë financiare për të justifikuar blerjen e tyre. Subjekti ka paraqitur shpjegimet e tij me shkrim si dhe një raport të një audituesi të licensuar mbi mundësinë e tij për të pasur një gjendje kesh.

Lidhur me kontrollin e figurës, **DSIK** ka paraqitur raportin me konstatimin mbi papërshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës. Ky raport është deklasifikuar pjesërisht nga komisioni i cili ka kërkuar rishikimin e tij. **DSIK** ka dërguar raportin me të dhënat shtesë për kontrollin e figurës duke konfirmuar konstatimin fillestar. Dhe raporti i dytë u deklasifikua pjesërisht nga KPK.

Raporti informon se situata pasqyron një korrupsion sistematik në vetë sistemin e drejtësisë ku në rastin në fjalë përfshihen në veprime korruptive të subjektit dy çështje të ndryshme, për të cilat KPK i ka kaluar subjektit barrën e provës. Z. Fatmir Lushi ka dhënë shpjegimet e tij dhe ka kërkuar :

- administrimin e disa vendimeve penale të Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër dhe të Gjykatës së Lartë;
- thirrjen e oficerës së policisë gjyqësore në cilësinë e dëshmitarit si dhe;
- këqyrjen e disa akteve në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

KPK ka rrëzuar kërkesën për thirrjen e dëshmitares dhe këqyrjen e akteve.

Për sa i përket parimit për një proces të rregullt ligjor, në këndvështrimin e kontradiktoritetit, trupi gjykues si dhe vëzhguesi ndërkombëtar i drejtuan disa pyetje subjektit si dhe i dhanë mundësi të shpjegohej.

Vlen të theksohet se Kryetarja e trupit gjykues i kërkoi disa here subjektit të jetë sa me konciz dhe efikas në shpjegimet e tij.

Në përfundim të seancës Subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

Trupi gjykues i përbërë nga kryetarja Suela Zhegu dhe dy anëtarët Brunilda Bekteshi (relatore) dhe Xhensila Pine u tërhoq për vendim.